



# BULETINI MUJOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE

(Pasqyra 14/Sh)

DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË  
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

KORRIK, 2019

Buletini Mujor i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimit të Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky buletin mujor bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14/Sh. Ai plotësohet në pasqyrën në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14/Sh për muajin korrik 2019 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) në rrethe.

## 1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike gjatë muajit korrik 2019 zënë 50 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14/Sh, dhe paraqesin një incidencë 285,81/100.000 banorë. Dihet që periudha e muajve të nxehtë të vitit mbart me vete frekuencën më të lartë të episodeve diarreike, ku në muajin korrik vihet re një tendencë në rritje e sëmundjeve diarreike. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha rrethet e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që në nivel kombëtar, helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 8.50/100.000 banorë. Rrethet Berat, Bulqizë, Kukës dhe Kavajë mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rrethëve të diagnozës së saktë klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.

Gjatë muajit korrik 2019 janë raportuar 10 raste të konfirmuara me Salmonelozë jotofoide nga NJVKSH Shkodër. Rastet janë konfirmuar nga “Laboratori mikrobiologjik” i NJVKSH Shkodër. Rastet janë nga njësi administrative të ndryshme, janë sporadike dhe nuk kanë lidhje epidemiologjike me njëra-tjetrën.

Rrethi i Shkodrës vazhdon të mbajë peshën kryesore të incidencës së Shigelozes për muajin korrik 2019 me 23 raste (1.38/10.000 banorë) të konfirmuara në laboratorin mikrobiologjik të NJVKSH-së Shkodër, që u përkasin grup-moshave të ndryshme.

Gjatë muajit korrik është raportuar nga rrethi i Elbasanit një rast me diagnozë Tifo abdominale, mashkull 72 vjeç, banor ne lagjen “28 Nëntori”, Elbasan. Pacienti është shtruar në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT), “Shërbimi i Infektivit” dhe është konfirmuar me tifo abdominale ne “Laboratorin e Bakteriologjisë”, ISHP. NJVKSH-Elbasan ka marrë masat përkatëse dhe nga hetimi rezultoi qe nuk ka pasur raste me gjendje febrile te zgjatur dhe gastroenterite nga Lagjja “28 Nëntori”, Elbasan.


**Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin Korrik 2019**  
(Incidenca raste/100.000 banorë)

	Raste Korrik 2019	Incidenca Korrik 2019 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	1	0.04
Salmonelozë	10	0.36
Shigelozë (Disenteri bacilare)	24	0.86
Dizenteri amebike	0	0
Helmime ushqimore	238	8.50
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	7730	276.06
Sëmundje diarreike në total	8003	285.81


## 2. Sëmundjet e parandalueshme nga vaksinat (EPI)

### 2.1. Fruthi

Gjatë muajit Korrik 2019 në kuadrin e vazhdimësisë së epidemisë së fruthit janë dyshuar në total 14 raste prej të cilave janë konfirmuar me IgM pozitiv 2 raste. Te dy rastet i përkasin rrethit të Tiranës dhe janë të grupmoshës 16-20 vjeç dhe 21-26 vjeç. Gjatë muajit Korrik vërehet një rënie e rasteve me Fruth. Një informacion më të zgjeruar ju mund ta gjeni në “Buletinin Javor të Fruthit”, në website të ISHP.



**Grafiku 1. Kurba epidemike e rasteve te dyshuara për fruth sipas datës se fillimit te rashit, Korrik 2019**



## Grafiku 2. Kurba epidemike e rasteve te dyshuara për fruth sipas datës se fillimit te rashit, Korrik 2018

Ne muajin Korrik te nje viti me pare, 2018 u raportuan ne total 79 raste prej te vileve 37 u konfirmuan nga ana laboratorike. Nga keto 21 raste ose 57 % i perkisnin rrethit te Tiranes. 33% ose 12 raste i perkisnin grupmoshes nen 2 vjec.

Siç shihet ne krahasim për te njëjtën periudhe me një vit me pare, numri i rasteve është ne rënie dhe mosha pediatrike vazhdon te jete me e prekur. Kjo për shkak edhe te mosvaksinimit dhe kontaktit apo vizitës te mëparshëm te tyre ne shërbimin pediatrik QSUT.

Te gjitha rastet janë konfirmuar ne Laboratorin e Virologjisë, ne ISHP.

### 2.2. Tuberkulozi pulmonar

Bazuar ne te dhënat e pasqyrës 14-Sh, gjatë muajit Korrik 2019 janë raportuar 29 raste te reja te konfirmuara me TBC pulmonar. Rastet pulmonare sputum pozitiv janë ne rrethet :15 raste ne Tirane, 3 raste ne Puke, 3 raste ne Elbasan, 2 raste ne Durrës, 2 raste ne Shkodër, 1 rast ne Fier, 1 rast ne Mirdite, 1 rast ne Vlore dhe 1 rast ne Lezhe.

Rastet e raportuara ne muajin Korrik i perkasin moshës mbi 15 vjec. Grupmoshat me te prekura janë 15-24 vjec, 25-34 vjec, 55-64 vjec dhe grup-mosha > 65 vjec (5 raste). Grup-mosha 60-64 vjec (4 raste), grup-mosha 30-34 vjec (4 raste) dhe grup-mosha 20-24 vjec (4 raste). Grupmoshat e tjera paraqiten me 1 ose 2 raste. Shqetësuese vijojejnë te mbeten hasja e rasteve me TB ne grup moshat e reja 15-24 vjec dhe 25-34 vjec.

### 3. Zoonozat

Gjatë muajit Korrik 2019 me anë të Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS), të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14/Sh, janë raportuar nga NJVKSH në nivel vendi katër raste me brucelozë, nga të cilat vetëm një rast është i konfirmuar. Rastet janë raportuar nga rrethet Tepelene, Gjirokastër dhe Lushnjë dhe i perkasin grup-moshës 40-59 vjec.

Gjatë muajit Korrik 2019 është raportuar një rast i konfirmuar me antraks kutan, blegtor, mosha 65 vjec nga NJVKSH Tepelene.

Dy raste me Leishmaniazë viscerale janë raportuar gjate këtij muaji nga rrethet Elbasan dhe Mat, te grup-moshës 1-4 vjec, te hospitalizuar. Një rast është konfirmuar.

**Tabela 2: Frekuenca dhe incidencat e sëmundjeve Zoonotike në Korrik 2019 (Incidenca raste/100.000 banorë)**

	Raste Korrik 2019	Incidenca Korrik 2019 (raste/100.000 banorë)
Antraks (Plasje)	1	0.04

Brucelozë	4	0.14
Leptospirozë	0	0
Leishmaniazë viscerale	2	0.07
Leishmaniazë kutane	0	0

#### 4. Hepatitet virale

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit Korrik 2019 janë raportuar në total 29 raste me hepatite virale akute (Incidenca 1.04/100.000 banorë), nga të cilat 6 raste janë hepatite virale të paspecifikuara, 22 raste Hepatite Virale B (HBV) të konfirmuara në laboratorët e NJVKSH Tirane dhe Kuçove


Në lidhje me HBV-në, 21 rastet e konfirmuara janë raportuar përkatësisht nga rrethi Tiranë (0.29/10.000 banorë), dhe një rast nga Kuçova. Rastet me Hepatit Viral B i përkasin grup-moshës së rritur.

Ne lidhje me HCV ne Pasqyrën 14 Sh është raportuar një rast i dyshuar, i hospitalizuar nga rrethi i Dibrës i grup-moshës 4-9 vjeç.

#### 5. Sëmundjet virale me vatra natyrore

Gjate muajit Korrik 2019 mbeshetur ne survejancen e bazuar ne rast jane raportuar 6 raste de dyshuar ethe hemorragjike. Rastet kane qene me nje shperndarje ne grup moshat 34-40 vjec (3 raste) dhe te grupmoshes + 65 vjec (3 raste). Sipas gjinise meshkuj / femra rastet e dyshuar kane patur raportin 5:1. Shperndarje gjeografike e rasteve ka rezultuar perkatesisht 4 raste nga zonat rurale (Librazhd, Lubonje- Korce, Pollozhan- Peshkopi) dhe 2 raste rnga zonat urbane, perkatesisht nga Tirana.

Persa i perket profesionit vetem nje nga rastet ka punuar si bari, me kullota ne Vithkuq, rasti nga Lubonje e Korces i cili si per nga natyra profesionale, shenjta klinike dhe ndryshimeve hemodinamike dhe te dhenave epidemiologjike ka permbushur perkufizimin e rastit per ethe hemoragjike nga ku dhe nga ana laboratorike prane laboratorit te Virologjise ne ISHP, ka rezultuar ne ELISA pozitiv per Hanan virus IgG dhe IgM.



**Grafiku 3.** Shperndarja e rasteve te dyshuar dhe te konfirmuar me ethe hemorragjike gjate muajit Korrik

Nderkohe qe raste e tjera ( 5 raste) kane qene shtepiake dhe te papune.

Vlen te theksohet se nga laborator i Virologjise prane ISHP, per muajin Korrik 2019 jane testuar dhe 5 mostrat e tjera te rasteve te dyshuara per ethe hemorragjike te cilat kane rezultuar negative ne ELISA IgG dhe IgM per ethe hemorragjike Hantanvirus.

Bazuar ne survejancen e arboviruseve per muajin Korrik eshte raportuar nje rast i dyshuar nga NJVKSH Vlore, 77 vjec, mashkull dhe mostra serike eshte testuar nga laborator i Virologjise ISHP, i cili ka rezultuar negativ ne ELISA per Hantan virus IgG dhe IgM.

## 6. HIV/AIDS

Ne muajin Korrik 2019 janë kryer ne total 38 ekzaminime për HIV, 24 meshkuj dhe 14 femra. Nga këto ekzaminime, **12 prej tyre kane rezultuar pozitive** (9 meshkuj dhe 3 femra). Rastet pozitive i përkasin grupmoshave si me poshtë: 4 raste grup-moshës 25-29 vjeç, 1 rast grup-mosha 40-44 vjeç, 1 rast grup-mosha 35-39 vjeç, 3 raste grup-mosha 45-49 vjeç, 2 raste grup-mosha 50-54 vjeç, 1 rast grup-mosha 55-59 vjeç. Shpërndarja sipas rretheve tregon se 3 raste i përkasin rrethit Tirane, 3 raste rrethit Shkodër, 3 raste Durrës, 1 rast Kurbin, 1 rast Lezhe dhe 1 rast i përket Vlorës.

**Mostrat e gjakut qe kane rezultuar pozitive kane ardhur ne ISHP si me poshtë:** 4 raste nga klinikat (dy “Shërbimi Infektiv”, QSUT dhe dy nga Spitali Universitar “Shefqet Ndroqi”), 2 vullnetare pranë ISHP-se, 2 raste nga BKTGJ, 1 rast nga laborator privat. 1 rast ndjekje epidemiologjike pas diagnozës se njërit prej partnereve, 1 nga VCT Vlore dhe 1 nga VCT Shkodër,

INSTITUTI I  
SHËNDETIT PUBLIK

DEKSI